



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.20/2024
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT
ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR. 06/2021 PËR NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR.MA 14/2004 PËR
REGJISTRIMIN DHE CAKTIMIN E TAKSËS PËR IMPORTUESIT,
EKSPORTUESIT DHE TREGTUESIT E MATERIALIT FIDANOR, TË
NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME UDHËZIMIN ADMINISTRATIV
MA NR.04/2007 DHE UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR.04/2011

¹ Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - Nr.20/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ NR.MA 14/2004 për regjistrimin, dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor, të ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ MA NR.04/2007 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.04/2011, i nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datën 09.08.2024.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA	
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT	
Arhiv Qendror - Centralno Arhiva - Central Archive	
Nr./Br./No.	3078
Nr. i fq./Br. Str./No. pg.	4+4+4
Data/Datum/Date:	13.08.2024
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA	

Në mbështetje të nenit 3, 15, 16 dhe 24 të Ligjit Nr.2004/13 për Materialin Fidanor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.22/01 Mars 2008), duke marrë parasysh nenin 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 07, dt. 01 Mars 2019), në pajtim me nenin 9 paragrafi 2 të Rregullore (QKR) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare 21.06/2024), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Nxjerrë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.20/2024
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MBPZHR)
- NR. 06/2021 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT
ADMINISTRATIV NR.MA 14/2004 PËR REGJISTRIMIN DHE CAKTIMIN E TAKSËS
PËR IMPORTUESIT, EKSPORTUESIT DHE TREGTUESIT E MATERIALIT
FIDANOR, TË NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME UDHËZIMIN ADMINISTRATIV
MA NR.04/2007 DHE UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR.04/2011

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ NR.MA 14/2004 për regjistrimin, dhe caktimin e taksës për importuesit, eksportuesit dhe tregtuesit e materialit fidanor, të ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ MA NR.04/2007 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.04/2011, me qëllim të krijimit të bazës ligjore për zbatimin e akteve nënligjore nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari që i përcaktojnë autoritetin licencues për material fidanor.

Neni 2

Neni 2 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjalia “Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje” zëvendësohet me fjalinë “Agjencia për Ushqim dhe Veterinari”.

Neni 3

Neni 2 i Udhëzimit Administrativ 06/2021 që ndryshon dhe plotëson nenin 3 të Udhëzimit Administrativ bazik riformulohet në tërësi si në vijim:

1. Personat të cilët merren me importimin, eksportimin dhe tregtimin e materialit fidanor duhet të regjistrohen në pajtim me dispozitat e ligjit dhe të këtij udhëzimi administrativ.
2. Për regjistrimin sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të paraqitet kërkesa në pajtim me dispozitat e Ligjit përkatës për procedurën e përgjithshme administrative (në vijim: LPPA).
3. Për regjistrimin e personave që merren me importimin, eksportimin dhe tregtimin e materialit fidanor duhet të plotësohen kushtet dhe kriteret si në vijim:

3.1. për personat juridik, informatën se janë të regjistruar si biznes në regjistrin përkatës të bizneseve;

3.2. të ketë të punësuar personin me përgatitje shkollore të mesme në lëmin e bujqësisë. Për këtë kriter duhet të ofrohet dëshmia e shkollimit dhe kopja e kontratës që dëshmon punësimin.

3.3. Dëshminë nga inspektorati fitosanitar se posedon objekt përkatës për deponimin, ruajtjen dhe tregtimin e materialit fidanor.

3. Për regjistrimin e personave të cilët merren me importimin, eksportimin dhe tregtimin e materialit fidanor zhvillohet procedura në pajtim me LPPA.

Neni 4

Neni 3 Udhëzimit Administrativ 06/2021 që ndryshon dhe plotëson nenin 4 të Udhëzimit Administrativ bazik, fshihet.

Neni 5

Neni 5 i Udhëzimit Administrativ bazik riformulohet si në vijim:

1. Për regjistrimin e personave të cilët merren me importimin, eksportimin dhe tregtimin e materialit fidanor nga organi licencues lëshohet certifikatë e cila përmban:

1.1. emrin dhe logon e autoritetit licencues;

1.2. numrin identifikues të certifikatës dhe datën e lëshimit;

1.3. të dhënat e personit të regjistruar;

1.4. llojin e materialit fidanor për të cilin bëhet regjistrimi;

1.5. lloji i veprimtarisë me të cilën ka të bëjë regjistrimi;

1.6. vendi i veprimtarisë, nëse ka;

1.7. nënshkrimi i personit të autorizuar për të nënshkruar në emër të autoritetit licencues.

Nënshkrimi bëhet në pajtim me rregullat e përcaktuara në LPPA.

2. Në sistemin elektronik krijohet certifikata elektronike e cila përmban të gjitha elementet sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe ka vlerën e njëjtë si certifikata fizike e cila mund të shkarkohet nga personi në çdo kohë përmes sistemit elektronik.

Neni 6

Nenet 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ 06/2021, fshihen.

Neni 7

Neni 4 i Udhëzimit Administrativ bazik, fjala Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje zëvendësohet Agjencia për Ushqim dhe Veterinari.

Neni 8

Neni 6 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje DPB&T” zëvendësohet me fjalën “Agjencia për Ushqim dhe Veterinari AUV”.


Neni 9

Në tërë tekstin e Udhëzimit Administrativ bazik dhe plotësim ndryshimet e tij, togfjalëshi “proces i licencimit” zëvendësohet me “proces të regjistrimit, ndërsa fjala licencë, fshihet.

Neni 10 **Hyrja ne fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Faton PEÇI



Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

____ / ____ /2024